



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 56

2002

Shtator

PËRMBAJTA

Faqe

Vendim i KM  
nr. 435, datë 12.9.2002

Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në  
Republikën e Shqipërisë..... 1579

**V E N D I M**  
**Nr. 435, datë 12.9.2002**

**PËR MIRATIMIN E NORMAVE TË SHKARKIMEVE NË AJËR  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 8897, datë 16. 5. 2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e normave të shkarkimeve në ajër, sipas anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Normat e shkarkimeve në ajër, të miratuara me këtë vendim, zbatohen vetëm nga subjektet, të cilat fillojnë veprimitarinë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Fatos Nano**

**ANEKS NR.1  
LISTA E NDOTËSVE**

Grupi 0. - Ndotësit bazë

Lëndë e ngurtë  
Okside të sqfurit  
Okside të azotit  
Oksidi i karbonit  
Grupi 1

Nëngrupi 1. asbesti benzo(a)pireni 2-naftil amina berilliumi dhe komponimet e tij të shprehura si Be kadmiumi dhe komponimet e tij të shprehura si Cd dibenzoantracen	Nëngrupi 2. arseniku dhe komponimet e tij të shprehura si As komponimet e kromit 6 valent të shprehura si Cr kobalti dhe komponimet e tij të shprehura si Co nikeli dhe komponimet e tij të shprehura si Ni
Nëngrupi 3. akrilonitrili benzen 1,3-butadien epiklorhidrin oksid etileni (oksiran) hidrazine oksid propileni klorur vinili	Nëngrupi 4. bifenilet e poliklorinuara dibenzofuranet e poliklorinuara dibenzodioxinat e poliklorinuara

Grupi 2

Nëngrupi 1. zhiva dhe komponimet e saj të shprehura si Hg talumi dhe komponimet e tij të shprehura si Tl	Nëngrupi 2. seleniumi dhe komponimet e tij të shprehura si Se telurumi dhe komponimet e tij të shprehura si Te
--	--

Nëngrupi 3.

antimoni dhe komponimet e tij të shprehura si Sb  
 kallaji dhe komponimet e tij të shprehura si Sn  
 floruret të shprehura si F-  
 kromi dhe komponimet e tij të shprehura si (me përjashtim të CrVI) Cr  
 cianuret të shprehura si CN-  
 mangani dhe komponimet e tij të shprehura si Mn  
 bakri dhe komponimet e tij të shprehura si Cu  
 plumbi dhe komponimet e tij të shprehura si Pb  
 vanadi dhe komponimet e tij të shprehura si V  
 zinku dhe komponimet e tij të shprehura si Zn

### Grupi 3

Nëngrupi 1.	Nëngrupi 2.
stibinë	bromi dhe komponimet e tij të gazta shprehura si HBr
arsinë	fluori dhe komponimet e tij të gazta shprehura si HF
fosfinë	klori
fosgen	acidi/gazi cianhidrik
klorur cianhidrik	sulfuri i hidrogjenit
	acidet e forta organikë të shprehura si H-
Nëngrupi 3.	
Amonjak	
Komponimet inorganike të gazta të klorit të shprehura si HCl	

### Grupi 4

Nëngrupi 1	Nëngrupi 2
Aldehid acetik	Aldehidi benzoik
Aniline	aldehid butilik
kloruri i benzenit	1,4-dyklorbenzene
dietil amine	etil benzeni
1,2-dy kloretan	furfural klorbenzene
1,1-dy kloretilen	2-kloropreni (2-klor-1,3-butadiene)
dy metil amina	2-kloropropan
etanol amine	isopropil benzeni
akrilati i etilit	acid acetik
fenol	acetat metili
aldehidi formik	metakrilati i metilit
krezole	1-metil naftalen
acid akrilik	2-metil naftalen
acid formik	naftalen
merkaptane	stiren
akrilati i metilit	toluen
metil amine	acetati i vinilit
nitrobenzen	ksilen
nitrofenol	
nitrokrezol	
nitrotoluen	
piridine	
sulfur karboni	
1,1,2,2-tetrakloroetan	
tetrakloretilen	
tioeter	
o-toluidine (2-metil aniline)	
triklorometan	
trikloroetilen	

Nëngrupi 3.
aceton
alkoli alkilik
dyfenil
2-butanon
acetat butili
eter dibutilik
eter dietilik
eter difenilik
1,2-dykloretilen
dyklormetan
eter dyisopropilik
eter dimetilik
acetat etili
etilen glikol
4-hydroksil-4-etil-2-pantanon
metil esteret eacidit benzoik
4-metil-2-pentanol
N-metil pirrolidon
olefina me përashtim të 1,3-
parafina me përashtim të metanit

#### ANEKS NR. 2

### KATEGORIZIMI I DISA BURIMEVE TË ZGJEDHURA TË NDOTJES, NORMAT E SHKARKIMEVE, SHKALLA E LEJUESHME E ERRËSISË SË TYMIT DHE KUSHTET TEKNIKE TË VEPRIMIT TË BURIMEVE TË ZGJEDHURA TË NDOTJES

#### KATEGORIZIMI I DISA BURIMEVE TE ZGJEDHURA TE NDOTJES

Për qëllimet e këtij aneksi do të përdoren emërtimet e mëposhtme:

kushte referimi A për normat e shkarkimeve që i referohen përqëndrimi të ndotësit përkatës në gaz të thatë në kushte normale (101.32 kPa, 0oC), që mund të shoqërohet nga përbajtja referuese e substancave të tjera në gazin mbartës (zakonisht oksigjen)

kushte referimi B për normat e shkarkimeve që i referohen përqëndrimi të ndotësit përkatës në gazin e njomë në kushte normale (101.32 kPa, 0oC), që mund të shoqërohet nga përbajtja referuese e substancave të tjera në gazin mbartës (zakonisht oksigjen)

kushte referimi C për normat e shkarkimeve që i referohen përqëndrimi të ndotësit përkatës në gazin e njomë në kushte normale veprimi.

#### 1. INDUSTRIA E PRODHIMIT TË ENERGJISË DHE TË LËNDËVE TË DJEGSHME

1.1 Djegia e lëndëve të djegshme për prodhim energjie elektrike ose termike në impiante teknike që përbajnjë pajisje të palëvizshme me kapacitet termik më të madh se 0.2 MW( burime të mëdha dhe të mesme ndotje)

Këto norma shkarkimesh janë njëloj të vlefshme edhe për pajisje të ngjashme që nuk i përkasin në vetvete industriale së lëndëve të djegshme dhe prodhimit të energjisë.

Normat e shkarkimeve janë të vlefshme për kushtet A të referimit dhe për përbajtje të oksigenit në gazin mbartës të paraqitur në kolonën 7.

Kapaciteti termik i instaluar [MW]	Normat e shkarkimeve [mg/m <sup>3</sup> ] për					Ref. përbajtja e oksigenit O <sub>2</sub> [%]
	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azotit NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
1	2	3	4	5	6	7

1.1.1Furra me qymyr tē grimcëzuar, me dhoma me zgarë zjarri me saracineske pēr shkarkimin e zgjyrës.1)

1	2	3	4	5	6	7
> 0.2	-	-	650 11002)	4000	-	6
> 0.2 - 1	150	-	-	1000	-	6
> 1 - 5	150	2000	500	250	-	6
> 0.2 - 5	150	-	-	-	-	6
> 0.2 - 50	-	2000	-	-	-	6
> 5 - 50	50	2000	500	400	-	6
> 50	50	-	-	250	-	6
> 50 - 300	50	1700	400	250	-	6
> 300	50	500	-	250	-	6

Shënim:

1) pēr furrat me qymyr tē grimcuar ose me zgare tē shoqëruar nga reaktorë me shtrat vlues dhe kombinimet e tyre me dhoma me shtrat vlues ose pēr rikonstruksionin e furave tē tilla që pērdorin elementë tē teknologjisë nē shtrat vlues.

2) furra zjarri me saracineske per derdhjen e zgjyrës.

#### 1.1.2Furrat e drurit1)

1	2	3	4	5	6	7
200- 500	150	-	2	-	900	13
500-1	150	-	2	-	500	13
1-5	150		2	50	250	11
>5	2)	2)	2)	2)	50	11

Shënim:

Njëlloj tē vlefshme pēr mbeturina druri që nuk janë tē ndotura, lëvozhga druri dhe lëndë drusore tē ngjashme, lëvozhga dhe lëndë bimore tē ngjashme

Normat e shkarkimeve pēr djegien e qymyrit sipas kapacitetit tē instaluar

#### 1.1.3Furrat më lëndë tē djegëshme tē lëngët

1	2	3	4	5	6	7
> 0.2	-	-	-	175	-	3
> 0.2 - 5	-	1)	500	-	-	3
> 0.2 - 50	100	1700	450	170	-	3
> 5	80	-	450	-	-	3
> 5 - 300	-	1700	-	-	-	3
> 50	50	1700	300	170	-	3
> 300	50	500	150	170	-	3

Shënim:

1)Pērbajtja e S nē lëndën e djegshme nuk duhet tē jetë më e madhe se 1% pērqind nē peshë.

#### 1.1.4Furrat me lëndë tē djegshme tē gaztë

1	2	3	4	5	6	7
<0.2			120	100		3
> 0.2	50 1)	35 2) 900 3)	100 200 4)	100	-	3

Shënim:

1)Pēr lëndë tē djegshme tē gazta nga rrjeti jo publik i shpérndarjes (gaz kaksi i pastruar, biogaz, propan ose butan ose pērzjerje tē tyre, gaz rafinerie)

2)Pēr lëndë tē djegshme tē gazta nga rrjeti publik i shpérndarjes

Për lëndë të djegshme të gazta përvèç rrjetit publik të shpërndarjes dhe gazit të koksit Në djegien e propanit ose butanit ose përzjerjeve të tyre.

Furrat me lëndë të djegëshme fosile të lëngët

1	2	3	4	5	6	7
> 5 - 50	100	800 75% 1)	400	250	-	6
> 50	50	500 75% 1)	400	250	-	6
< 5 2)				-	-	6

Shënim:

1) Nëse nuk është e mundur të arrihen normat e shkarkimeve kur përdoren lëndë të djegshme për përdorim shtëpiak me një përzjerje të pranueshme shtesash, përqëndrimi duhet të zvogëlohet të paktën deri në 25% të vlerës origjinale

2) Normat e shkarkimeve për furrat me shtrat vluas, me kapacitet termik specifik më të ulët se 5MW duhet të jenë të njëjtë me normat e shkarkimeve për furrat klasike në varësi të llojit të lendës së djegëshme të përdorur.

Njësitë e prodhimit të energjisë me motorra me djegie me piston

1	2	3	4	5	6	7
> 0.2 1)	130 2)	3)	2000 4) 4000 5) 500 6)	650	150 7)	5 8)

Shënim:

1) njësitë e prodhimit klasifikohen sipas inputeve (hyrjes)

2) kur përdoren lëndë të djegshme të lëngëta

3) kur përdoren lëndë të djegshme diesel, përmbajtja e squfurit nuk duhet të jetë më e madhe se 0.05% në peshë; përmbajtja e squfurit në lëndë të tjera të djegshme të lëngëta nuk duhet të jetë më e madhe se 1% në peshë; kur përdoren lëndë të djegshme të gazta, përmbajtja totale e squfurit nuk duhet të jetë më e madhe 2200 mg/m<sup>3</sup> e rillgaritur ndaj përmbajtjes në metan, ose 60 mg/MJ e nxehësisë së prodhuar nga lënda të djegshme e përdorur

4) për motorra diezel me fuqi më të madhe se 5 MW

5) për motorra diezel me fuqi deri në 5 MW, përfshi edhe vlerën 5

6) për motorra me djegie të brendshme

7) përqëndrimi i përgjithshëm i të gjitha substancave me përjashtim të metanit kur prurja në masë është më e madhe se 3 kg/h

8) oksid karboni dhe oksidet e azotit duhet të jenë objekt i normave të shkarkimeve për gazin e thatë; normat e shkarkimeve për ndotësit e ngurtë dhe substancat organike duhet të jenë të vlefshme për gazin e njomë.

#### 1.1.7 Sistemet e nxehjes direkte me ajër të nxehë 1)

1	2	3	4	5	6	7
> 0.2	2)	2)	2)	2)	2)	17

Shënim:

1) sistemet që përmbajnë pajisje në të cilën flaka ose përzjerja e produkteve të nxehta të djegies janë në kontakt të drejtpërdrejtë me ajrin e nxehë, pjesë e të cilit siguron një burim oksigjeni për djegien e lëndës së djegshme; lënda e djegshme mund të jetë e gaztë, e furnizuar nga rrjeti publik i shpërndarjes së lëndëve të djegshme, si dhe gjithashtu propan, butan ose përzjerje e tyre, ose lëndë të djegshme e lëngët pa përmbajtje plumbi, me përmbajtje squfuri deri në 0.05% në peshë, një lëndë e tillë e djegshme duhet të repetojë kushtet teknike të vendosura nga prodhuesi

2) vlerat numerike të normave të shkarkimeve për furrat sipas lëndës së djegshme të përdorur.

## Turbinat e gazit

Kapaciteti termik i instaluar	Normat e shkarkimeve [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referuese
[MW]	Lëndë të ngurta (LN) 2	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub> 3	Okside azoti si NO <sub>2</sub> 4	Oksid karboni CO 5	Lëndë organike si Σ C 6	O <sub>2</sub> [%] 7
< 60 000	100 1)	120	80	100	-	15
≥ 60 000	50 2)	120	120	100	-	15

Shënim:

1- për djegien e lëndëve pezull të qymyrit dhe të gazeve të centraleve termike të prodhimit të energjisë nga rrjeti jo publik i shpërndarjes; në djegien e lëndëve të djegshme të lëngëta dhe gazeve të nxehta nga rrjeti publik i shpërndarjes, norma e shkarkimeve është errësia e tymit e matur sipas shkallës Bacharach, dhe nuk duhet të kalojë nivelin 4 të ngjyrës së zezë për të gjitha kushtet e veprimit.

2- për djegien e lëndëve pezull të qymyrit dhe të gazeve të centraleve termike të prodhimit të energjisë nga rrjeti jo publik i shpërndarjes; në djegien e lëndëve të djegshme të lëngëta dhe gazeve të nxehta nga rrjeti publik i shpërndarjes, norma e shkarkimeve është errësia e tymit e matur sipas shkallës Bacharach, dhe nuk duhet të kalojë nivelin 2 të ngjyrës së zezë në kushtet normale të veprimit dhe nivelin 3 gjatë periudhës së lëshimit në punë.

### 1.2Djegia e disa lloj lëndësh të djegshme në të njëjtën pajisje

1- Në rastin kur në një pajisje të vetme djegieje digjen disa lloj lëndësh të djegshme, ku një lloj lënde e djegshme digjet në një kohë të dhënë, janë të vlefshme ato norma shkarkimesh që i përgjigjen lëndës të djegshme që është përdorur.

2- Në rastin kur në një pajisje të vetme djegieje digjen disa lloj lëndësh të djegshme, normat e shkarkimeve duhet të rrjedhin nga norma e shkarkimit për atë lëndë të djegshme që kontribuon 75% ose më shumë në kapacitetin termik.

3- Nëse asnjë nga llojet e lëndëve të djegshme të përdorura nuk kontribuon në kapacitetin termik të pajisjes në mënyrë të tillë, atëherë duhet të vendosen norma e shkarkimit dhe referenca e përbajtjes së oksigjenit si dhe mesatarja e peshuar e vlerave të normave të shkarkimeve ose vlerat e referimit të oksigjenit për secilën lloj të lëndës të djegshme të përdorur, ku faktori peshë duhet të përbëjë kontributin e çdo lënde të djegshme në kapacitetin termik të pajisjes.

### 1.3Integrimi i furrave me turbinat e gazit

1- Në rast se produkti i djegies së një furre që është lidhur pas një turbine gazi pa nxehje shtesë ose me nxehje shtesë nga e njëjta lënde e djegshme në një sasi deri 20% të kapacitetit termik të turbinës së gazit, atëherë kjo vendosje duhet të jetë subjekt i të njëjtave norma të shkarkimit dhe gjendje referimi për përcaktimin e tyre si dhe për gazin e turbinës me fluksin korrespondues të vëllimit.

2- Në rast se një produkt i djegies së një furre është lidhur pas një turbine gazi me nxehje shtesë që përdor një lëndë të djegshme të ndryshme ose kapacitet termik që përdor të njëjtën lëndë të djegshme tejkalon 20% të kapacitetit termik të turbinës së gazit, norma e shkarkimeve dhe gjendja e referimit të përbajtjes oksigjenit duhet të përcaktohen si mesatare e peshuar e vlerave të vendosura për turbinën e gazit dhe furrës në mënyrë të ndarë, bazuar në kontributet e kapacitetit termik të turbinës dhe nxehjes shtesë nga furra.

3- Kapaciteti termik i pajisjes duhet të përcaktohet me llogaritje nga kapaciteti i nxehësisë dhe sasia e lëndës së djegshme, duke përdorur vlerën minimale të kapacitetit të nxehësisë të lëndës të djegshme të garantuar nga prodhuesi i saj nën kushte standarte teknike. Nëse kjo vlerë nuk jepet, ajo duhet përcaktuar si shumë e kapaciteteve termike të përbërsve të lëndës të djegshme; përbajtja mesatare tyre në lëndët e djegshme duhet të përcaktohet me analizë.

#### 1.4 Pasurimi dhe trajtimi i qymyrit, Briketat

Norma e shkarkimit në [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja ref. në oksigjen O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Lëndë të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	Lëndë organike si $\Sigma$ C		
1	2	3	4	5	6	7
a) Pasurimi ose trajtim tjeter i qymyrit (burime mesatare të ndotjes)						
100	-	-	-	-	-	B
b) Trajtimi termik i qymyrit (burime të mëdha ndotje)						
100	-	-	-	50	5	A

Prodhimi i koxsit (burime të mëdha ndotje me përashtimet e shënuara në tabelë)

Norma e shkarkimit në [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referente në oksigjen O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Lëndë të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	Lëndë organike si $\Sigma$ C		
1	2	3	4	5	6	7

Nxehja e baterive të koxsit

e pacaktuar	1)	500	-	-	5	B
Përgatitja e reaktorëve me shtrat fiks të koxsit (coke batch) (Burime mesatare ndotje)						
100	-	-	-	-	-	C
Koksifikimi						
2)	-	-	-	-	-	-
Prodhimi i koxsit në formë ekstrudati						
1003)	-	-	-	-	-	B
Pasurimi I koxsit (Burime mesatare ndotje)						
100	-	-	-	-	-	B

Shënim:

përbajtja më e madhe e sulfurit të hidrogjenit në gazin e nxehjes është 500 mg/m<sup>3</sup>

duhet të vendosen norma për shkarkimet e lejuara të dukshme për çdo bateri koxsi në rregulloren lokale të veprimit si pjesë e masave teknike organizative (§ 2.2 par. 2 të ligjit të ajrit të pastër)

e llogaritur si mesatare ditore.

Kërkosat për projektimin, pajisjen dhe/ose veprimin e proceseve teknologjike

Cdo clirim i ndotësve në ajër duhet të minimizohet me anë të zgjerimit dhe largimit të pluhurave ose mbylljes hermetike, nëse kjo është teknikisht e mundshme.

Gazet mbushës (në dhomat e mbushjes së koksifikimit) duhet të ushqehen në gazin e koxsit të ashpër ose në disa dhoma të tjera koksifikimi. Kushtet për zhvillimin e ciklit operacional duhet të vendosen në kushtet lokale operacionale

Sasia e substancave të ngurta të shkarkuara në ajër kufizohet në vlerën 0.1 kg/t të koksit të thatë total (tdc). Lloji dhe cilësia e ujit ftohës duhet të vendoset në rregulloren lokale të veprimit si pjesë e masave teknike organizative.

Pajisja e operacioneve kimike të impianteve të koksit duhet të ruhet kundër clirimtë të substancave volatile në ajrin e jashtëm. Ujërat e ndotur gjatë ftohjes së drejtpërdrejtë të gazeve nuk duhet të hyjnë në kontakt të drejtpërdrejtë me ajrin.

Përmbytja e hidrogenit të sulfuruar (H<sub>2</sub>S) në gazin e koksit në kapacitetin e operacioneve kimike nuk duhet të kalojë vlerën 500 mg/m<sup>3</sup>). Përmbytja e gazit sulfidrik duhet të përcaktohet me matje operacionale të vazhdueshme.

Nuk duhet lejuar shkarkimi në ajër i gazeve të impiantit të prodhimit të koksit.

1.6 Prodhimi i energjisë në impiantet me gaz (gaz gjeneratori, gaz kaksi) dhe gaz sinteze (burimet e mëdha të ndotjes)

Normat e përgjithshme të shkarkimeve për ndotësit e ngurtë, dyoksidin e sulfurit, oksidet e azotit, oksidin e karbonit, hidrogenin e sulfuruar, amonjakun dhe merkaptanet janë njëlloj të vlefshme për t'u zbatuar sipas kushteve A të referimit.

## 2. PRODHIMI INDUSTRIAL DHE PËRPUNIMI I METALEVE

Kërkesat për projektimin, pajisjen dhe/ose veprimin e proceseve teknologjike

Për procese me veprim të ndërprerë me shkarkime të ndryshueshme, duhet të vendosen normat e shkarkimeve për parametrat mesatarë të proceseve teknike.

Të gjitha shkarkimet e ndotësve të ngurtë në ajër nga burimet e specifikuara në kapitullin 2 duhet të minimizohen me anë të zgjerimit dhe largimit të pluhurave ose mbylljes hermetike nëse kjo është e mundshme teknikisht.

2.1 Shkrirja e mineraleve të hekurit dhe manganit (burime të mëdha ndotje me përjashtim të atyre të shënuara në tabelë)

Norma Shkarkim [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përmbytja referente e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Lëndë të ngurta (LN)	Dyoksid sulfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	të tjera		
1	2	3	4	5	6	7
Përgatitja e reaktorëve me veprim periodik (burime mesatare ndotje)						
100	-	-	-	-	-	C
Brezat e aglomerimit të shkrirjes						
100	400	400	6000 8000 1)	2)	19	A
Operacionet e shkrirjes 3) (burimet mesatare të ndotjes)						
100	-	-	-	-	-	C

Shënim:

për mineralet karbonate

Përmbytja e zhivës në gaz, max. 1 mg/m<sup>3</sup>

të tillë si ftohja, copëtimi, bluarja, klasifikimi

2.2 Trajtimi i mineralit të hekurit (burime të mëdha ndotje me përjashtim të atyre të shënuar në tabelë)

Norma shkarkimesh [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referente e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Lëndë të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	të tjera		
1	2	3	4	5	6	7

Transportimi dhe vënia në funksionim e ngarkesave të fyrjeve të furrës (burim mesatar)

50	-	-	-	-	-	C
----	---	---	---	---	---	---

Derdhja

50	-	-	-	-	-	C
----	---	---	---	---	---	---

Prodhimi i çelikut (burime të mëdha ndotje me përjashtim të atyre të shënuar në tabelë) (shembull: konvertorë, furra Siemens Martin, furra me dy zemra, furra marz Bohlen)

Norma shkarkimesh [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referente e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Lëndë të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	të tjera		
1	2	3	4	5	6	7

Transporti dhe funksionimi i reaktorëve me veprim periodik 1) (burime mesatare)

100	-	-	-	-	-	C
-----	---	---	---	---	---	---

Furra zemre me intensifikim oksigjeni

50	400	400	-	-	-	C
----	-----	-----	---	---	---	---

Konvertor oksigjeni

50 2)	-	-	-	-	-	C
-------	---	---	---	---	---	---

Hark elektrik dhe furre me veprim periodik deri në 20 t duke përfshirë edhe këtë vlerë

75/50	-	400	1000	-	-	C
-------	---	-----	------	---	---	---

Furre me induktim elektrik me veprim peroidik mbi 5 ton

75	-	-	6000	-	-	C
----	---	---	------	---	---	---

Shënim:

Ndarja e mbetjeve me metale të rënda me anë të prerjes me flakë oksigjeni duhet të kryhet me anë të zgjerimit të ajrit dhe pastrim të menjëhershëm njëpasnjëshëm të gazit të mbetur aty ku teknikisht është e mundur; procedura e veprimit duhet të vendoset në kushtet lokale të veprimit si pjesë e masave tekniko organizative (§ 5.2 par.2 të ligjit për ajrin e pastër).

Gazi i konvertorëve duhet të mblidhet duke marrë në konsideratë aftësitë përpunuese dhe mund të përdoret më tej; vlera numerike e normës së shkarkimit është njëloj e vlefshme për rastet kur ky gaz shkarkohet në ajër.

2.4 Prodhimi i derdhjeve/kallëpeve të hekurit (burime të mëdha ndotje me përjashtim të atyre të shënuar në tabelë)

Norma shkarkimi [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referente e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Lëndë të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	të tjera		
1	2	3	4	5	6	7

Transporti dhe veprimet me produktin 1), 5) (burim mesatar ndotje)						
100	-	-	-	-	-	C
Shkrirja në furra me hark elektrik						
75	-	400	1000	-	-	C
Shkrirja në furra me induksion elektrik me ngarkesë 5 tons (burim mesatar ndotje)						
75	-	-	-	-	-	C
Furrë me kupolë 2)						
100	-	-	1000 3)	-	-	C
Shkrirja në furrat me cilindër rrrotullues me lëndë të djegshme gaz/lëng						
30/20	4)	400	300/200	-	-	C

Shënim:

që përfshin nyjet e tjera teknike si linjat e trajtimit, prodhimi i formave(kallëpeve) dhe zemrave, derdhja, pastrimi i derdhjeve, operacionet përfundimtare

ndotësit e gaztë nga gazet e furrave me fryrje mund të eliminohen nëse teknikisht është e mundshme

në oxhak përtëj rekuperuesve të furrave me kupolë me erë të nxeh të

përbajtja e squfurit në lëndë të djegshme nuk duhet të kalojë max. 1 % në peshë.

ndotësit e gaztë inorganikë dhe organikë të formuar në prodhimin e formave duhet të mblidhen.

## 2.5 Trajtimi i mineraleve metalore jo ferrikë

a) Norma shkarkimi për ndotës të ngurtë 20 mg/m<sup>3</sup>

b) Në përpunimin e mineralit për të përfthuar plumb, ndryshe nga gërmë a) 10 mg/m<sup>3</sup>

c) Shuma e substancave organike e shprehur si karbon total < 50 mg/m<sup>3</sup>

Prodhimi i metaleve të lehta alkalinë dhe aliazhet e tyre 1) (burime të mëdha ndotje me përjashtim të atyre të shënuar në tabelë) (magnez, alumin, berillium, natrium, kalium, etj.)

Norma shkarkimi[mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referente e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Lëndë të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	Të tjera		
1	2	3	4	5	6	7
Transporti dhe veprimet me lëndën e parë dhe produktet						
100	-	-	-	-	-	C
Agregatet e furrës						
50 2)	-	400	1000	-	-	C
Prodhimi elektrolitik I aluminit						
30 3)	-	-	-	2 4)	-	C

Shënim:

vlerat e përgjithshme të normave të shkarkimit janë njëloj të vlefshme për tu zbatuar për ndotësit e ngurtë në prodhimin elektrolitik, me përjashtim të prodhimit të aluminit

Norma e shkarkimeve për ndotësit e ngurtë në gazet e mbetjes nga sistemet e zgjerimit 100 mg/m<sup>3</sup>

në gazin e mbetjes nga elektrolizeri; shkarkimet specifike të prodhimit të ndotësve të ngurtë duke përfshirë gazet e zgjeruara nga zona të prodhimit elektrolitik, të gjetura nga vlerat mesatare ditore, nuk duhet të kalojë vlerën e 5 kg/t alumin të prodhuar

nga zona e elektrolizerëve dhe prodhimit të elektrolizës; shkarkimet specifike të përbërsve të florit, të shprehur si anhidrit fluorhidrik, që përfshin në gazet e cliruara nga zonat e prodhimit elektrolitik, të gjetura nga vlerat mesatare ditore, nuk duhet të kalojë vlerën e 700 g/t alumin te prodhuar

2.7 Prodhimi i metaleve të tjera joferrike dhe aliazhet e tyre (burime të mëdha ndotje me përjashtim të atyre të shënuar në tabelë)

Norma shkarkimi [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referente e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Substanca të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	të tjera		
1	2	3	4	5	6	7
Transporti dhe trajtimi i lëndëve të para (burimet mesatare të ndotjes)						
100	-	-	-	-	-	C
Agregatet e furrës						
100	-	400	1000	-	-	C

Prodhimi i aliazheve të hekurit (burimet e mëdha të ndotjes me përjashtim të atyre të shënuar në tabelë)

Norma shkarkimi[mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referente e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Lëndë të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	të tjera		
1	2	3	4	5	6	7
Transporti dhe trajtimi i lëndëve të para (burimet e mëdha të ndotjes)						
100	-	-	-	-	-	C
Agregatet e furrës						
50	-	-	-	-	-	C

## 2.9 Produkte të tjera metalurgjike speciale (burime të ndotjes)

Norma shkarkimi[mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referente e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Lëndë të ngurta (LN)	Dyoksid squfuriSO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboniCO	të tjera		
1	2	3	4	5	6	7
Transporti dhe trajtimi i lëndës së parë 1) 2)						
100	-	-	-	-	-	C
Shkrirja e metaleve të hekurit dhe aliazheve të tyre						
75	-	400	1000	-	-	C
Veshja e nxehëtë e zingut						
10	-	-	-	10 3)	-	C

Shënim:

1) që përfshin nyjet të tjera teknike si linjat e trajtimit, prodhimi i formave dhe modeleve, derdhja, pastrimi i derdhjeve, operacionet e përpunimit përfundimtar

2) ndotësit organikë dhe inorganikë të gaztë të gjeneruara nga prodhimi i formave duhet të grumbullohen.

3) kufij shkarkimesh për zingun.

2.10 Trajtimi sipërfaqesor i metaleve 1) (burime mesatare të ndotjes) (si psh veshja metalore galvanike, fosfatizimi, zmaltimi, lustrimi, bluarja, fryrja dhe operacionet e lidhura me to)

Normat e shkarkimit në [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referuese e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Substanca të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	të tjera		
1 100	2 -	3 1500 2)	4 -	5 3)	6 -	7 C

Shënim:

- 1) me përjashtim të zbatimit të veshjeve
- 2) në trajtimet sipërfaqësore të metaleve që përdorin acid nitrik për pajisje që punojnë në mënyrë të pandërprerë (banja)
- 3) për ndotës të tjerë janë të vlefshme pika 5 par. 2 të këtij aneksi.

### 3. PRODHIMI I PRODUKTEVE MINERALE JOMETALORE

(burimet e mëdha të ndotjes me përjashtim të atyre të shënuar në tabelë)

#### 3.1 Asbesti dhe produktet e asbestit

Jane të vlefshme normat e përgjithshme të shkarkimit për asbestin

3.2 Guroret dhe impiantet e përpunimit të tyre, Transportimi i gurëve, Proçesi dhe funksionimi - Gurët natyrorë dhe artificialë (burime mesatare ndotje)

Të gjitha vendet dhe proceset në të cilët ndotësit e ngurtë emtohen në ajër duhet të pajisen sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së proçesit, me rrjeta uji ose sperkatje, heqje pluhurash ose sisteme spërkateje.

3.3 Prodhimi i cementos, gëlqeres, magneziteve, përzjerjeve të veshura, shkrirja e lëndëve të para

Normat e shkarkimeve [mg/m <sup>3</sup> ] për				Prodhime specifike të tjera	Përbajtja referuese e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Substanca të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO			
1	2	3	4	5	6	7
<b>Prodhimi i cementos</b>						
50 1)	400 2)	800 2)	-	1.5 3)	-	C
<b>Prodhimi i gëlqeres</b>						
50 1)		1800 4) 1500 5)	6)	1.57)	-	C
<b>Prodhimi i magneziteve dhe prodhimi i materialeve me qëndrueshmëri të lartë ndaj nxehësisë, quarcit, etj.</b>						
501)	400 8)	1500 8)	-	1.5 9)	-	C
<b>Përzjerjet e veshura me asfalt dhe impiantet e përzjerjes së asfalteve</b>						
20	10)				17 11)	A
<b>Shkrirja e lëndëve të para në furrat me kupolë me kapacitet shkrirje &lt; ose 10 t/orë</b>						
100/75		12)		-		C

Shënim:

për të gjitha operacionet që përfshijnë clirim e lëndës së ngurtë në suspension në mjedisin rrethues për djegien e klinkerit në furrat rrotulluese

shkarkimet e prodhimit specifik të lëndës së ngurtë në suspension nga i tërë impianti i prodhimit të cimentos,

për furrat rrotulluese

për llojet e tjera të furrave

në prodhimin e gëlqeres në furrat me cilindër të koksit, gazet e mbeturat nuk duhet jenë në përmbytje më të madhe se 1% në vëllim.

Shkarkimet specifike të prodhimit të lëndës së ngurtë në pezulli nga i tërë impianti i gëlqeres duke përfshirë edhe magazinimin dhe dorëzimin e lëndës së parë dhe të produkteve, të gjetur si mesatare vjetore për një ton për gëlqere të djegur ose të përpunuar.

nga djegia e materialeve

Shkarkimet specifike të prodhimit të lëndës së ngurtë në suspension nga i tërë impianti duke përfshirë edhe magazinimin dhe dorëzimin e lëndës së parë dhe të produkteve, të gjetur si mesatare vjetore për një ton material të djegur të prodhuar.

përmbytja e squfurit në lëndën e djegshme të lëngët nuk duhet të jetë më e madhe se 1% peshë.

për pajisjet e përzjerjes; kushtet C të referimit për operacionet e tjera.

shkarkimet e monoksidit të karbonit duhet të ulen në nivelin maksimalisht të mundur bazuar në mundësitet tekniqe dhe përshtashmërinë e shpenzimeve.

### 3.4Qelqi, Fibrat e qelqit dhe Fibrat minerale

Normat e shkarkimeve [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referuese e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Substanca të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	të tjera		
1	2	3	4	5	6	7
Prodhimi i qelqit dhe produkteve të qelqta, fibrave të qelqit dhe fibra të tjera minerale dhe qelqurina për prodhim bizhuterish						
150 1) 100 2)	500 7) 1000 8)	2500 9) 1100 10) 1600 11) 12)	800 13)	10 5) 5 6) 50 14 100 15)	13 3) 17 4)	A A
Prodhimi i fibrave minerale që përmbytjnë lidhës organikë						
50 16) 75 17)	-	-	-	18)	-	C
Përpunimi dhe përmirësimi i qelqit (lustrimi, ngjyrimi, presimi, shkrirja nga gjysëm produktet etj.) dhe prodhimi i bizhuterive me kapacitet deri në 5 t /vit (burime mesatare)						
-	-	-	-	719) 20)	-	C

Shënim:

më të ulët së 2. kg/h

për prurje në masë të barabartë ose më të madhe se 2.5 kg/h

për aggregate shkrirje me veprim të vazhdueshëm

për aggregate shkrirje me veprim periodik

për plumb, antimon, manganez, vanad, kallaj, bakër, për një prurje në masë të barabartë ose më të madhe se 0.05 kg/h

për kobalt, nikel, krom, arsenik, kadmium, selen, për një prurje në masë të barabartë ose më të madhe se 0.01 kg/h

për djegien e gazit natyror

për lëndë të djegshme të tjera

për rigjenerim të aggregatëve të shkrirjes me veprim të vazhdueshëm

për rigjenerim të aggregatëve të shkrirjes me veprim periodik

për rikuperim që përdorin aggregatë me shkrirje me veprim të vazhdueshëm

në pastrimin e nitrates, masa korresponduese e përqëndrimit të oksideve të azotit nuk duhet të jetë më e madhe se dyfishi i vlerës së dhënë.

Për një prurje në masë më të madhe se 5 kg/h

komponimet e fluorit të shprehur si fluorur hidrogjeni, në një prurje në masë të barabartë ose më të madhe 0.05 kg/h.

komponimet e klorit të shprehur si klorur hidrogjeni, në një masë fluksi 0.05 kg/h ose më të madhe

në gazet e mbetur me origjinë sistemet e shfryrjes, transportin, operimin e reaktorëve me shtrat fiks dhe të tjera pajisje që emetojnë lëndë të ngurta në suspension.

në gaze të tjera që vijnë nga proçest e precipitimit, forcimit dhe tharjes së fibrave minerale me lidhësa organikë.

lidhur me përqëndrimin e lejuar të substancave organike në gazet e mbetur duhet të zbatohen normat e përgjithshme të shkarkimeve.

vlerat e përgjithshme të normave të shkarkimit janë njëloj të vlefshme për tu zbatuar edhe për ndotës të tjerë karakteristikë të lidhura me proçesin teknologjik të dhënë.

#### 4. INDUSTRIA KIMIKE

(burime të mëdha ndotje me përjashtim të atyre të shkruara në tekst)

4.1.Nxjerrja, transportimi, manipulimi dhe magazinimi i Naftës dhe Gazit Natyror

Gjatë nxjerrjes, transportimit, përpunimit dhe magazinimit të Naftës dhe Gazit Natyror duhet të përdoren të gjitha masat teknike të disponueshme për të zvogëluar emetimin e ndotsave në ajër.

4.2.Rafineritë e naftës, Përpunimi petrokimik i naftës, Prodhimi, Përpunimi dhe magazinimi i produkteve petrokimike dhe substancave të tjera organike të lëngëta

4.2.1.Magazinimi dhe përpunimi

Kërkesa për ndërtimin, pajimin ose vënien në punë të proçeseve teknologjike

1- Në magazinimin e lëndëve të para, produkteve të ndërmjetshëm dhe produkteve me trusni avulli më të madhe se 1.32 kpA në temperaturë 20oC, tanket e magazinimit me vëllim më të madh se 1000 m<sup>3</sup> ose rezervuaret e magazinimit të burimeve me një prodhim vjetor më të madh 10 000 m<sup>3</sup> duhet të pajisen si vijon:

rezervuarë ruajtje me çati të jashtme të lustruar dhe me përputhje efektive të qosheve të çatisë;

rezervuari me çati fikse të pajisur me një çati të brendshme levizëse duhet të përputhen me efikasitet me mbyllje që sigurojnë uljen e shkarkimeve të paktën 90% krahasuar me shkarkimet nga rezervuarët me çati fikse por pa masa të tjera;

ose një rezervuar me çati fikse duhet të pajiset me pajisje për mbledhje, riqarkullim dhe heqjen e avujve nga lëngje të tillë me efikasitet të paktën 99%. Ky efikasitet duhet të mos arrihet duke përdorur djegien, me përjashtim të rasteve kur rikondensimi i avujve është i rrezikshëm dhe i pamundshëm të realizohet teknikisht. Djegia mund të përdoret gjithashu si fazë e dytë e pastrimit;

2-Rezervuarët duhet të përputhen me izolim të përshtatshëm dhe veshje anti reflektuese me të paktën 70% rrezatim të nxehësisë radiante me qëllim zvogëlimin e ndryshimeve të vëllimit në lëngun e rezervuar si pasojë e ndryshimeve të temperaturës së mjedisit të jashtëm; Kjo masë është e efektive në një shkallë të kënaqshme, për rezervuarë ruajtje me vëllim deri 1000 m<sup>3</sup> ose për burime me prodhim vjetor deri 10 000 m<sup>3</sup>.

3- Për pompimin e substancave me trysni avujsh më të madhe se 1.32 kPa në temperaturë

20oC (për shembull gjatë shkarkimit nga rezervuaret e lëvizshëm, ose gjatë ngarkimit të tyre nga rezervuaret e magazinimit), duhen krijuar kushtet për grumbullimin, riqarkullimin dhe eleminimin e substancave të tillë me efikasitet jo më të vogël se 99% dhe:

Duhet të përdoren pompa që ndalojnë rrjedhjen e substancave të pompuara për shembull me blokim mekanik,

Duhet që të paktën një linjë operimi për ngarkimin e rezervuareve të lëvizshëm duhet të pajiset për të ngarkuar tanket e lëvizshëm të ngarkimit nga fundi,

linja veprimi për mbushjen e rezervuareve të lëvizshëm nga lart duhet të sigurohen në mënyrë që gjatë ngarkimit, fundi i tubit mbushës të qëndrojë në fundin e autobotit.

#### 4.2.2 Gazeret dhe avujt nga linjat e prodhimit

Kërkesa për ndërtimin, pajisjen ose vënien në punë të proçeseve teknologjike

a) Gazet e mbetur që dalin, të cilët janë formuar gjatë operacioneve normale, vënies në punë, ndalimit të veprimit, riparimeve të linjave teknike, si dhe gazet e mbetur të formuar gjatë proçesit të rigjenerimit të katalizatorit duhet të vecohen për trajtime të mëtejshme ose djegie, ose duhet të përdoren disa masa të tjera efikase për të ulur sasinë e shkarkimeve.

b) Detyrimet e pikës a) nuk duhet të zbatohen për linjat që janë kompletuar në rast emergjencash, si sustat e valvolave të shpëtimit, membranat e shpëtimit, mbylljet hidraulike ose sisteme të tjera që mbrojnë sistemin pavarësisht nga shërbimi i personelit, ku kapja, kthimi dhe heqja e njëpasnjëshme e tyre do të ishte shkatërruese për kushtet e sigurisë në punë.

#### 4.2.3 Sulfuret (H2S)

Kërkesa për ndërtimin, pajisjen ose vënien në punë të proçeseve teknologjike

a) Gazet e mbetur që dalin nga linjat e pastrimit të squfurit ose burime të tjera me një përqëndrim në masë të gazit sulfuror të barabartë ose më të madhe se 6000 mg/m<sup>3</sup>, dhe për prurje në masë të barabartë ose më ta madhe se 80 kg/h duhet të përpunohen më tej.

b) gazet e mbetur që dalin sipas pikës a), që nuk mund të trajtohen më tej, duhen likujduar me mënyra të tjera psh me djegie.

c) Përqëndrimi në masë i hidrogenit të sulfuruar në gazin e pastruar, nuk duhet të jetë më i madh se 10 mg/m<sup>3</sup>.

#### 4.2.4 Regjenerimi dhe aktivizimi i katalizatorëve për procese katalitike në shtresë valuese.

Norma shkarkimi [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja referuese e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Substanca të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	të tjera		
1	2	3	4	5	6	7
50	1700	1700	-	-	17	A

#### 4.2.5 Ujërat e përdorur dhe të ballastit

Ujërat e përdorur duhet të degazohen përpara dërgimit në impiantin e trajtimit të ujërave të përdorur. Gazet e cliruar duhet të mblidhen dhe të pastrohen me larje ose me djegie.

4.3 Stacionet e shërbimit dhe linjat e transportimit të lëndëve të djegshme për motorra automjetesh (burime mesatare ndotje)

Vlerat e përgjithshme të normave të shkarkimit janë njëloj të vlefshme për t'u zbatuar edhe për linja të tillë.

#### 4.4 Prodhimi i substancave organike

Normat e Shkarkimeve [mg/m <sup>3</sup> ] për					Përbajtja Referuese e oksigjenit O <sub>2</sub> [%]	Kushte referimi
Substanca të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO <sub>2</sub>	Okside azoti si NO <sub>2</sub>	Oksid karboni CO	të tjera		
1	2	3	4	5	6	7

#### 4.4.1 Prodhimi i 1,2-dykloretanit dhe klorurit të vinilit

1	2	3	4	5	6	7
1,2-dykloretan ose klorur vinili (2)	-	5	-	-	C	1)

Shënim:

1) Gazet e mbetur që dalin duhet të dërgohen në një linjë përpunimi për uljen e shkarkimeve.

2) Vlerat e përgjithshme të shkarkimeve të 1,2-dykloretan ose klorur vinili janë të vlefshme pavarësisht nga prurjet në masë

#### 4.4.2. Prodhimi i polimerëve bazuar në poliakrilonitrile

1	2	3	4	5	6	7
akrilonitril	-	0.2 1) 5 2)	-	-	C	3)
akrilonitril	-	10	20	-	C	4)
akrilonitril	-	10 5) 35 6)	-	-	C	7)
akrilonitril	-	-	25	-	C	8)

Shënim:

në linja trajtimi për të ulur shkarkimet me anë të djegies

në dalje të linjave të tjera trajtimi për zvogëlimin e vëllimit të shkarkimeve prodhim fibre

prodhimi dhe përpunimi i polimerëve ACN

në procesin e njomë të formimit dhe të prodhimit të fibrës

në procesin e thatë të formimit të fibrës

rrotullimin e fibrës

prodhimi i polimerëve ABS (lënda).

Kërkesa për ndërtimin, pajisjen ose vënien në punë të proceseve teknologjike

Të gjitha gazet që përbajnë akrilonitril të përdorur në thurjen e fibrave, në përbajtje më të madhe se 5 mg/m<sup>3</sup>, të gjithë gazet nga reaktorët, enët mbledhëse të pezullive dhe ujërat e shplarjes së filtrit, që përbajnë akrilonitril dhe butadien, duhet të grumbullohen dhe trajtohen në një linjë apo pajisje për të zvogëluar vëllimin e shkarkimeve të tyre.

#### 4.4.3. Prodhimi i PVC

1	2	3	4	5	6	7
klorur vinili	-	5	-	-	C	1)
klorur vinili	-	-	-	103) 1004)	C	2)

Shënim:

gazet e mbetur që dalin, që përbajnë klorur vinili duhet të grumbullohen dhe pastrohen ose të likujdohen me rrugë termike.

përbajtja e ngelur e klorurit të vinilit në vendin e kalimit nga sistemi i mbyllur në një sistem të hapur trajtimi ose tharje, si mesatare mujore

për produkte përfundimtare në impiantin e PVC

në pezullinë e polimerit në impiantin e PVC

#### 4.4.4. Prodhimi i pulpës, duke përfshirë edhe përpunimin e mbeturinave të prodhimit

1	2	3	4	5	6	7
dyokside i squfurit	-	-	-	2000 1)	C	2)
komponimet e squfurit të shprehura si squfur	-	-	-	350 3)	C	4)

Shënim:

që përfshin shkarkimet nga djegia e ekstrakteve të sulfiteve, për njësi të pulpës së thatë të prodhuar të fermentuar plotësisht

në procesin e prodhimit të sulfiteve

për likujdim qëndror të substancave me erë, për njësi prodhimi të pulpës së thatë të fermentuar plotësisht

për procesin e prodhimit të sulfateve

Kërkesa për ndërtimin, pajisjen ose vënien në punë të proceseve teknologjike

Në prodhimin e pulpës, duhen përdorur të gjitha masat teknike të disponueshme për të zvogëluar ose likujduar substancat me erë nga burime individuale shkarkimesh si për shembull, autoklavë, avullues, kolonë zjerje) dhe pas tërheqjes lokale ose qëndrore të gazit, ai duhet të dërgohet në një linjë trajtimi për zvogëlimin e shkarkimeve.

#### 4.4.5. Prodhimi dhe përpunimi i viskozës

1	2	3	4	5	6	7
hidrogjen i sulfuruar sulfur karboni	- -	10 100	-	-	C C	-
hidrogjen i sulfuruar sulfur karboni	50 400	- -	- -	- 200 000 2)	C C	1)
hidrogjen i sulfuruar sulfur karboni	200 3)	-	-	-	C	2)

Shënim:

në prodhimin e litarit prej mëndafshi

në prodhimin e fillit dhe mëndafshit pëlhirë

përgjithësht për hidrogenin e sulfuruar dhe sulfurin e karbonit

Kërkesa për ndërtimin, pajisjen ose vënien në punë të proceseve teknologjike

a) Gazet e mbetur, që dalin nga nga prodhimi i viskozës, përgatitja e banjave të rrotullimit dhe, aty ku teknikisht është e mundur, dhe nga proceset e tjera të veprimit, duhet të mblidhen për trajtim në një linjë të zvogëlimit të shkarkimeve të ndotësve.

b) Makineritë për rrotullimin e fibrës për procese rrotullimi me veprim të vazhdueshëm duhet të mbyllen dhe gazet e formuara duhet të tërhiqen prej tyre dhe grumbullohen për trajtim në një linjë zvogëlimi shkarkimesh të përbërsve ndotës.

c) Ujërat e përdorur që përmbajnë hidrogen të sulfuruar dhe dy-sulfur karboni duhet të degazohen dhe gazet që dalin duhet të mblidhen për trajtim në një linjë per pakesimin e shkarkimeve të përbërsve ndotës.

#### 4.4.6. Prodhimi i kimikateve për mbrojtjen e bimëve

Përqëndrimi në masë i komponimeve të ngurta ndotëse që përmbajnë lëndë të qëndrueshme (që i rezistojnë për kohë të gjatë biodegradimit natyror), lëndë që akumulohen menjëherë ose lëndë me shkallë të lartë toksiciteti, në gazet e mbetur që dalin nga prodhimi, bluarja, përzjerja, paketimi dhe ringarkimi i substancave për mbrojtjen e bimëve dhe farerave nga parazitet nuk duhet të kalojë vlerën 5 mg/m<sup>3</sup> për një prurje në masë më të madhe 25 gram/orë.

#### 4.4.7. Prodhimi i substancave ndihmëse për industrinë e gomës

Përqëndrimi në masë i komponimeve të ngurta në gazin e karrierës në prodhimin e SO<sub>2</sub> nuk duhet të jetë më i madh se 20 mg/m<sup>3</sup> për çdo dalje në ajër.

Kërkesa për ndërtimin, pajisjen ose vënien në punë të proceseve teknologjike

Proçesi i prodhimit të SO<sub>2</sub> duhet të pajiset me linja për djegje të menjëhershme të gazeve në dalje që përmbajnë lëndë që marrin flakë dhe mbetjet e pandara të blozës, ku djegia e mëpastajme duhet të kryhet në temperaturë të paktën 1100oC me 2% vëllim në oksigjen në produktet e djegies; në të kundërt, kjo djegie duhet të kryhet me proces katalistik.

Pajisja për djegien e gazit duhet të punojë me regjim të vazhdueshëm.

4.4.8 Prodhimi dhe përpunimi i yndyrnave dhe vajrave me origjinë bimore dhe shtazore (burim mesatar ndotje)

Kërkesa për ndërtimin, pjisjen ose vënien në punë të proceseve teknologjike

1) Pajisjet e procesit, duke përfshirë edhe zonat e magazinimit, ku pritet prania e aromave të forta, duhet të vendosen në sipërfaqe të mbyllura.

2) Ajri në këto sipërfaqe duhet të tërhiqet dhe të dërgohet në pajisjet për pastrimin e gazeve të mbetur ose mund të përshtaten masa të tjera për të zgogëluar shkarkimet.

3) Lëndët e para, produktet dhe produktet ndërmjetës që pritet të shoqërohen me aromë, duhet të vendosen në enë të mbyllura të pajisura me sistem ftohje.

4.4.9 Prodhimi i argjilave dhe produkteve lidhëse (burim mesatar ndotje)

Janë njëloj të vlefshëm për tu zbatuar pikat e par. 4.4.8.

4.5 Prodhimi i substancave inorganike

Ndotës	Kufij shkarkimesh [mg/m <sup>3</sup> ]	Prodhim specifik shkarkimesh [kg/t]	Kushte Referimi	Shënim
1	2	3	4	5
1	2	3	4	5

4.5.1 Prodhimi i klorit 1)

1	2	3	4	5
Klor	62)	0.003 3)	C	-

Shënim:

- 1) Të gjitha llojet e gazeve përfundimtare, gazet që dalin nga procese teknikë që përbajnë klorinë duhet të mblidhen dhe trajtohen në një linjë të përshtatshme për largimin e klorinës.
- 2) Në gazin e karrierës nga elektroliza dhe oksidimi katalistik
- 3) Shkarkimet mesatare vjetore të zhivës nga operacionet elektrolitike, të përcaktuara si mesatare mujore për njësi të klorinës së prodhuar.

4.5.2 Prodhimi i acidit klorhidrik

1	2	3	4	5
klorur hidrogjeni	25	0.051)	C	-

